

RREGULLORE

PËR

HAPAT PROCEDURALË

TË UNIFIKUAR

Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore

Nr. 197 datë 23.02.2023

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është standardizimi i rregullave dhe hapave proceduralë që ndiqen gjatë procesit të vlerësimit të subjekteve nga trupa e vlerësimit.

Neni 2

Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:
 - a. rregullave dhe procedurave për organizimin e mbledhjes së parë të trupave të vlerësimit;
 - b. rregullave dhe procedurave për komunikimin e trupës së vlerësimit me subjektin;
 - c. rregullave dhe procedurave për hetimin dhe përfundimin e procesit të vlerësimit;
 - d. rregullave dhe procedurave për zhvillimin e seancave dëgjimore dhe shpalljen e vendimit për subjektin e vlerësimit.

Neni 3

Parimet e veprimtarisë

1. Gjatë veprimtarisë verifikuese dhe vlerësuese të subjekteve të vlerësimit sipas ligjit nr.128/2021“Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore” dhe ligjit nr.12/2018 i ndryshuar, trupat vlerësuese e ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke zbatuar parimin e:
 - a. transparencës;
 - b. të drejtës për informim;
 - c. konfidencialitetit,
 - d. ruajtjes së sekretit shtetëror,
 - e. mbrojtjes së të dhënave personale, etj.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Punonjës i AMP-së” është personi i emëruar në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të nëpunësve civilë.
2. “Punonjës policie” është personi i emëruar në Policinë e Shtetit, me gradë policore, në përputhje me ligjin për Policinë e Shtetit.
3. “Punonjës i Gardës së Republikës” është personi i emëruar në Gardën e Republikës, me gradë, në përputhje me ligjin për Gardën e Republikës së Shqipërisë.
4. “Subjekt vlerësimi” janë punonjësit, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, referuar nenit 6, të ligjit 12/2018 i ndryshuar.

5. "Trupë vlerësimi" është njësia e vlerësimit e organizuar në formën e organit kolegjal përgjegjës për shqyrtimin, verifikimi dhe marrjen e vendimeve ndaj punonjësve që do të vlerësohen sipas ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.
6. "Procesi i vlerësimit" përfshin si procesin kalimtar, ashtu dhe procesin periodik të vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

KREU II

Neni 5

Mbledhja e parë e trupave të vlerësimit

1. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përcaktimi i subjekteve të vlerësimit sipas shortit të hedhur, çdo trupë vlerësuese zhvillon mbledhjen e parë, gjatë së cilës:
 - a) Deklarohet konflikti i interesit nga anëtarët e trupës vlerësuese;
 - b) Zgjidhet kryesuesi i trupës vlerësuese për çdo subjekt;
 - c) Bëhet prezantimi paraprak i dosjes nga çdo relator;
 - d) Vendoset për njoftimin e subjektit të vlerësimit për fillimin e procedurave të vlerësimit, njohjen me përbërjen e trupës dhe të drejtën e deklarimit të konfliktit të interesit, si dhe dërgimin e formularit tip;
 - e) Vendoset për fillimin e hetimit kryesisht, si dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e vlerësimit;
 - f) Në rast se subjekti deklaron konfliktin e interesit me anëtarin/ët e trupës së vlerësimit, përjashtimi i tij do të vendoset nga një trupë tjetër vlerësuese, në përputhje me procedurat standarde të vlerësimit.

Neni 6

Njoftimet

1. Njoftimi dhe çdo komunikim midis subjektit dhe Trupës së vlerësimit do të bëhet në adresën elektronike të vendosur nga vetë subjekti i vlerësimit në formularët e deklarimit.
2. Në rast se njoftimi nuk realizohet me anë të adresës elektronike, do të përdoren format e tjera të komunikimit, parashikuar nga Kodi i Procedurave Administrative.

Neni 7

Fillimi i hetimit kryesisht

Për komponentin e pasurisë:

1. Brenda 72 orëve nga mbledhja e parë kryhet dërgimi i listës së emrave të subjekteve të vlerësimit të shortuar së bashku me deklaratat e pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues pranë ILDKPKI-së.
2. ILDKPKI zhvillon një procedurë të plotë kontrolli dhe brenda 120 ditëve nga dorëzimi i dosjeve të subjekteve vë në dispozicion raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar sipas nenit 33/1 të ligjit 12/2018, të ndryshuar, së bashku me dokumentacionin justifikues.
3. Pas dorëzimit raportit nga ana e ILDKPKI-së Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore kanë të drejtë të kryejnë verifikim shtesë të pavarur brenda 60 ditëve nga vënia në dispozicion e raportit, me të drejtë shtyrje deri në 30 ditë dhe marrin vendim.

Për komponentin e kontrollit të figurës:

4. Brenda 72 orëve nga mbledhja e parë kryhet dërgimi i listës së emrave të subjekteve të vlerësimit të shortuar së bashku me deklaratat e figurës pranë strukturës përgjegjëse të AMP-së.
5. Struktura përgjegjëse pranë AMP-së zhvillon një procedurë të plotë kontrolli dhe brenda 120 ditëve nga dorëzimi i deklaratës së figurës të subjektit vë në dispozicion të trupës vlerësuese raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar që ka përgatitur sipas ligjit 12/2018, të ndryshuar, së bashku me dokumentacionin justifikues.
6. Pas dorëzimit të dosjes dhe raportit nga ana e Strukturës përgjegjëse pranë AMP-së, Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore kanë të drejtë të kryejnë verifikim shtesë të pavarur brenda 60 ditëve nga vënia në dispozicion e raportit, me të drejtë shtyrje deri në 30 ditë dhe marrin vendim.

Për komponentin e profesionalizmit:

7. Brenda 72 orëve nga mbledhja e parë kryhet dërgimi i listës së emrave të subjekteve të vlerësimit të shortuar së bashku me deklaratat e vlerësimit të aftësive profesionale pranë strukturës përgjegjëse të burimeve njerëzore/standardeve profesionale.
8. Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standardeve profesionale zhvillon një procedurë të plotë kontrolli dhe brenda 120 ditëve nga dorëzimi i deklaratës së profesionalizmit të subjektit vë në dispozicion të trupës vlerësuese raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në elementët vlerësues të përcaktuar në nenin 45, pika 2 e ligjit 12/2018, të ndryshuar, së bashku me dokumentacionin justifikues.
9. Pas dorëzimit të dosjes dhe raportit nga ana e Strukturës përgjegjëse të burimeve njerëzore/standardeve profesionale, Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore kanë të drejtë të kryejnë verifikim të pavarur, të thelluar dhe brenda 60 ditëve nga vënia në dispozicion e raportit, me të drejtë shtyrje deri në 30 ditë dhe marrin vendim.

Neni 8

Parime të përgjithshme për marrjen e provës

1. Relatori i çështjes, pasi studion dosjen, ndërmerr hapat proceduralë për të siguruar provat e nevojshme për procesin e vendimmarrjes së trupës vlerësuese.
2. Trupa e vlerësimit përcakton dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për procesin e vlerësimit.
3. Deri në përfundim të hetimit, relatori mund t'i kundërdrejtojë subjektit pyetje shtesë, të cilat i konsideron të nevojshme për hetimin.
4. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, trupa e vlerësimit në mbështetje të nenit 80 të Kodit të Procedurës Administrative, ka të drejtë:
 - a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertë;
 - b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
 - c) të vizitojë apo të kontrollojë mallrat apo vende të përfshira.

Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.

5. Trupa e vlerësimit çmon, sipas bindjes së saj, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.
6. Trupat e vlerësimit vendosin duke u bazuar në prova, të dhënat dhe informacionit të vërtetuar në mënyrë ligjore, që disponojnë dhe në vlerësimin e çështjes në tërësi.
7. Në rast kur marrja e informacioneve dhe të dhënave shtesë, çmohet si e domosdoshme për marrjen e një vendimi, trupa e vlerësimit mund të pezullojë procedurën deri në marrjen e këtyre provave, të dhënave apo informacioneve.

Neni 9

Procedura e provës me dëshmitarë

1. Trupa e vlerësimit kërkon administrim të provës me dëshmitarë me qëllim vërtetimin e fakteve dhe rrethanave të procesit.
2. Subjekti kërkon marrjen e provës me dëshmitar:
 - a. depoziton gjatë hetimit administrativ kërkesë për marrjen e provës me dëshmitarë,
 - b. ose kërkon në seancë marrjen e provës me dëshmitarë.
3. Në rastet kur trupa e vlerësimit verifikon nëse “Kërkesë për thirrjen e dëshmitarit” është në kushtet e neneve 231-234 të K.Pr.C dhe nenin 80 pika 1 germa a të K.Pr.A, vendos me vendim të ndërmjetëm “Pranimin e kërkesës për marrjen e provës me dëshmitarë, njoftimin e dëshmitarit për t’u paraqitur në ditën dhe orën e caktuar dhe shtyrjen e seancës.
4. Në rastet kur “Kërkesë për thirrjen e dëshmitarit” është në kushtet e nenit 235 apo nuk plotëson kushtet e neneve 231-234 të K.Pr.C, trupa e vlerësimit vendos “Refuzimin e kërkesës për thirrjen e dëshmitarit”, duke i komunikuar subjektit të drejtën e ankimit ndaj refuzimit për të marrë provën me dëshmitar së bashku me vendimin përfundimtar.
5. Seanca dëgjimore, ku do të merret prova me dëshmitar:
 - a) Kryetari pasi verifikon prezencën në sallë, identitetin e dëshmitarit dhe ftohet të qëndrojë në këmbë.
 - b) Kryetari citon “Më lejoni t’ju ndërgjegjësoj mbi rëndësinë dhe misionin e betimit, ku ju jeni të detyruar të tregoni të vërtetën për atë çfarë dini në lidhje me çështjen, duke ju paralajmëruar për përgjegjësinë që keni për dëshmi të rremë.
 - c) Lexohet formulari i betimit “I ndërgjegjshëm, betohem se do të them të vërtetën dhe vetëm të vërtetën”. Betoheni?
 - d) Pritet përgjigja e betimit nga dëshmitari: Betohem!
 - e) Ftohet të ulët dëshmitari dhe i jepet fjala subjektit të vlerësimit për ti drejtuar pyetje dëshmitarit.
 - f) Pasi përfundon subjekti, ftohen anëtarët e trupës së vlerësimit nëse kanë pyetje për dëshmitarin.
 - g) Pasi pyeten serish, subjekti dhe anëtarët nëse nuk kanë më pyetje, Kryetari deklaron se:
“Dëshmitari është i lirë”.

Neni 10

Procedura e provës nga të tretë

1. Në kuadër të zhvillimit të procesit të hetimit administrative sipas ligjit, bazuar në nenin 83 të Kodit të Procedurës Administrative, mund të lindë nevoja që për marrjen e provave dhe informacioneve tek të tretët, kur subjekti deklaron dhe provon se nuk ka mundësi që ti marrë vetë këto prova dhe vlerësohen si të domosdoshme për realizimin e qëllimit të procesit.
2. Në këtë rast Trupa e Vlerësimit dërgon “Kërkesë për informacion” drejtuar institucioneve apo të tretëve.

Neni 11

Marrja e provës me ekspert

1. Në çështje për të cilat kërkohen njohuri të posaçme në fushën e teknikës e fusha të tjera të ekspertizës, Trupa e Vlerësimit, vendos vetë ose me kërkesën e subjektit të vlerësimit caktimin e një eksperti të fushës përkatëse në zbatim të nenit 80 pika 1 germa a të Kodit të Procedurës Administrative dhe nenit 227 të Kodit të Procedurës Civile.
 - a) Mbi bazë të kërkesës së subjektit apo me iniciativën e vetë organit administrativ, merret “Vendimi për caktimin e ekspertit”, duke e zgjidhur atë ndërmjet personave që janë regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në fushën përkatëse, duke caktuar edhe datën kur eksperti do bëjë betimin dhe do marrë detyrat. Vendimi për caktimin e ekspertit bëhet në 3 kopje, ku një kopje i njoftohet me shkresë përcjellëse subjektit të vlerësimit, një kopje i dërgohet me shkresë përcjellëse ekspertit të caktuar dhe një kopje mbahet në dosjen e vlerësimit.
 - b) Në shkresën përcjellëse së bashku me njoftimin e vendimit, i bëhet e ditur subjektit edhe e drejta që ai ka në lidhje përjashtimin e ekspertit, propozimin e një eksperti tjetër, të marrë vetë pjesë në ekspertim.
 - c) Në lidhje me çdo pretendim të subjektit sa i përket vendimit të caktimit të ekspertit, Trupa e Vlerësimit e vlerëson këtë pretendim, duke vendosur pranimin ose mospranimin me Vendim të Ndërmjetëm.
 - d) Trupa e Vlerësimit përpara se eksperti të marrë detyrat, i kujton atij rëndësinë e funksioneve për të cilat është thirrur për t’i përmbushur dhe e fton të bëjë betimin se do të kryejë mirë e me nder detyrat që i janë besuar, me të vetmin qëllim që t’ia bëjë të ditur të vërtetën.
 - e) E fton ekspertin të betohet.
 - f) I cakton detyrat.
 - g) Përcakton detyrimin se nga kush do të paguhet tarifa e ekspertit.

Neni 12

Procedura e marrjes së informacionit të vënë në dispozicion nga publiku në denoncimin e fakteve.

1. Trupa e vlerësimit është e detyruar të verifikojë informacionin e dhënë nga një person i njohur ose anonim.
2. Informacioni anonim merret në konsideratë kur përmbajtja lejon verifikimin e tij dhe përmban elemente të rëndësishme për procesin e vlerësimit.
3. Informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore, sipas kritereve të vlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat

ligjore, rrethanat për faktet, që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhënat për identitetin e personit.

Neni 13

Përfundimi i hetimit kryesisht dhe dërgimi i relacionit paraprak

1. Në përfundim të hetimit kryesisht dhe vlerësimit të fakteve e rrethanave të nevojshme për procedurën e vlerësimit, relatori përgatit relacionin paraprak të hetimit, ua përcjell anëtarëve të trupës së vlerësimit dhe njofton kryesuesin për thirrjen e mbledhjes së trupës.
2. Në këtë mbledhje, trupa e vlerësimit, pasi dëgjon relatorin, shqyrton gjetjet dhe jep opinionin për vazhdimin e hetimit kryesisht ose mbylljen e tij.
3. Në rast të vazhdimin të hetimit kryesisht, relatori merr masa për kryerjen e procedurës së nevojshme.
4. Kur trupa gjykon se janë ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm hetimorë për përfundimin e hetimit kryesisht dhe provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 53 dhe 54 të ligjit 12/2018, të ndryshuar, merr vendim për përfundimin e tij dhe njoftimin e subjektit si më poshtë vijon:
 - a) Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht.
 - b) Për rezultatet e këtij hetimi.
 - c) Të drejtën për t'u njohur me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrë një kopje të tyre. Dosja i vihet në dispozicion subjektit sipas neneve 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke respektuar të drejtat e palëve sipas neneve 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative.
 - d) Të drejtën e subjektit për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve apo marrjen e çdo prove mbështetëse. Kjo kërkesë duhet të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme për identifikimin dhe kontaktimin e dëshmitarit, si dhe të dhëna mbi thelbin e informacionit të pritshëm.
 - e) Afatin brenda të cilit duhet bëjë kërkesën me shkrim për njohjen me dosjen dhe të paraqesë prova/shpjegime me shkrim apo të bëjë kërkesa në përputhje me germet "c" dhe "d" të këtij neni.
 - f) Ky afat nuk mund të jetë më pak se 5 ditë dhe jo më shumë se 20 ditë nga data e njoftimit të subjektit për t'u njohur me dosjen.

Neni 14

Provat apo faktet e reja pas njohjes me dosjen

Në rast se dosjes së subjektit të vlerësimit, i cili e ka ushtruar të drejtën e tij/saj për t'u njohur me dosjen, i shtohen prova apo fakte të reja, që ndikojnë në vendimmarrje, për të cilat subjekti nuk ka marrë dijeni, ky subjekt do të njoftohet përsëri për t'u njohur me to, sipas procedurës më sipër.

Neni 15

Relacioni Përfundimtar

Kur dosja është gati, pasi ka përfunduar edhe afati për dorëzimin e provave dhe shpjegimeve me shkrim nga subjekti, relatori përgatit relacionin përfundimtar dhe e vë në dispozicion të trupës së vlerësimit.

Neni 16

Seanca dëgjimore

Trupa, në mbledhjen e thirrur nga kryesuesi vendosë për kalimin e çështjes në seancë dëgjimore. Në këtë rast trupa vendos për njoftimin e subjektit, për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës dëgjimore.

1. Afati për zhvillimin e seancës dëgjimore nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë nga data e njoftimit të subjektit për tu dëgjuar në seancë.
2. Seanca dëgjimore është publike dhe zhvillohet sipas përcaktimeve në nenin 20 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar dhe Kodit të Procedurave Administrative.
3. Seanca dëgjimore hapet nga kryesuesi i trupës gjyquese, i cili pasi identifikon subjektin e vlerësimit dhe/ose përfaqësuesin e tij, prezanton trupën vlerësuese dhe ia jep fjalën relatorit të çështjes.
4. Relatori i çështjes bën një përmbledhje të shkurtër të dosjes, si dhe të hapave proceduralë hetimorë të ndërmarrë. Pas relatorit, i jepet fjala subjektit të vlerësimit/përfaqësuesit të tij, për të bërë një deklaratë fillestare mbi themelin e çështjes. Koha e caktuar për këtë mund të kufizohet në mënyrë të arsyeshme nga kryesuesi i trupës së vlerësimit.
5. Trupa e vlerësimit ka të drejtë të marrë në pyetje punonjësin, i cili ka të drejtë të mos u përgjigjet pyetjeve. Pyetjet mund të përfshijnë njohuritë dhe aftësitë praktike në fushën e veprimtarisë së punës, ku punonjësi ka ushtruar detyrën vitin e fundit, si dhe plotësime të deklarimeve të bëra më parë nga vetë punonjësi.
6. Punonjësi ka të drejtë të dëgjohet dhe të japë shpjegimet e veta në lidhje me raportin e trupës së vlerësimit apo faktet e diskutuara në seancë. Në këto raste, trupa e vlerësimit ka të drejtë të kufizojë, në mënyrë të arsyeshme, kohën e parashikuar për t’u shprehur nga ana e punonjësit.
7. Bisedimet për marrjen e vendimit bëhen në përputhje me pikën 7 të nenit 56 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

Neni 17

Shpallja e vendimit

1. Vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore nga kryesuesi i trupës së vlerësimit.
2. Vendimi me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit.
3. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, duke respektuar kërkesat e ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 5 ditë pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm.